1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
  - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
  2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të kualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraprak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontratës;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

1	2	3	4	5	6=4 x 5
Shërbimi	Përshkrimi i riparim-shërbimeve mirëmbajtëse	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total
1	Kontroll vizual për funksionim normal të sobave, linjave të gazit, linjave elektrike etj.	Orë pune	1		
2	Kontrolli, diagnostifikimi i performancës së sistemit të mbrojtjes, sinjalizimit dhe sensorëve të gazit dhe kryerja e çdo shërbimi për funksionim normal	Orë pune	1		
3	Kontrolli dhe shërbim mirëmbajtës për montim dhe mbyllje të plotë të derës së furrës	Orë pune	1		
4	Pastrimi i përgjithshëm (i thellë) i sobave një herë në muaj përfshirë edhe bazën materiale (përzjerje e uthull dhe soluzion enësh apo tjetër të lejueshëm)	Orë pune	1		
5	Kontroll, mirëmbajtje e rrjetit furnizimit me energji elektrike të komandimit dhe të mbrojtjes	Orë pune	1		
6	Kontroll, matje e tokëzimit	Orë pune	1		
7	F.v. grilë gatimi për vatër	copë	1		
8	F.v. vatër Ø 230-270	copë	1		
9	F.v. vatër Ø320	copë	1		
10	F.v. vatër 16-18kW	copë	1		
11	F.v. rezistencë elektrike të tryezës së gatimit 630 W	copë	1		
12	F.v. rezistencë elektrike të furrës së gatimit 1200 W	copë	1		



13	F.v. termokop deri 850 9x1	copë	1		
14	F.v. termokop deri 600 9x1	copë	1		
15	F.v. çentil për ndezje gazi	copë	1		
16	F.v. bobinë tensioni për çentil për ndezje gazi	komplet	1		
17	F.v. fiye kandelediv1600 mmm	copë	1		
18	F.v. kandelediv M4	copë	1		
19	F.v. kandelediv me një elektrodë	copë	1		
20	F.v. kandelediv me dy elektroda	copë	1		
21	F.v. tub fleksibël inox Ø6, 300 mmm, me rekorde	copë	1		
22	F.v. tub fleksibël inox Ø6, 400 mmm, me rekorde	copë	1		
23	F.v. tub fleksibël inox Ø6, 600 mm, me rekorde	copë	1		
24	F.v. tub fleksibël inox Ø10, 900 mm, me rekorde	copë	1		
25	F.v. tub fleksibël inox Ø10, ÷1500 mmm, me rekorde	copë	1		
26	F.v. tub inox Ø10 për furnizim bombulë ambient jashtë kuzhine deri në sobë përfshirë hapje vrime në mure dhe kthim i murit gjendje fillestare	ml	1		
27	F.v. kafaz metalik me dry për instalim bombula jashtë ambientit ku janë në funksionim sobat	komplet	1		
28	F.v. brucator pilot	copë	1		
29	F.v. kontrollor elektronik + termokopie	copë	1		
30	F.v. brucator serie 600	copë	1		
31	F.v. brucator serie 900	copë	1		
32	F.v. brucator vertikal 11÷ 11,5 kW	copë	1		
33	F.v. brucator vertikal 8÷ 8,5 kW	copë	1		
34	F.v. brucator vertikal 6÷6,5 kW	copë	1		
35	F.v. programator 230 V, 50Hz	copë	1		
36	F.v. programator me rezistencë termike 13A/240V	copë	1		
37	F.v. grup furnizimi me gaz për furrë	copë	1		
38	F.v. termostat rregullator temp. 50-300° C	copë	1		
39	F.v. çelës rregullator për furrë sobe me gaz	copë	1		
40	F.v. rubinet G1/2"	copë	1		
41	F.v. rubinet termostatik 100÷300°C	copë	1		
42	F.v. rubinet sigurie me ndezje flake M9	copë	1		
43	F.v. sprucator M8x0,75	copë	1		
44	F.v. nipples M8x0,75	copë	1		
45	F.v. pipë gazi me hyrje 3/4"	copë	1		
46	F.v. dritë jeshile	copë	1		

47	F.v. dritë e kuqe	copë	1		
48	F.v. matës kohe elektronik për soba profesionale me gaz	copë	1		
49	F.v. zile elektronike 220 V, AC	copë	1		
50	F.v. sensor flake plus mbyllje automatike e furnizimit me gaz	copë	1		
51	F.v. kavo e sensorit të flakës	copë	1		
52	F.v. portollampë dhe llampë	copë	1		
53	F.v. dorezë furre	copë	1		
54	F.v. buton inoks 22 mmm	copë	1		
55	F.v. buton inoks 30 mmm	copë	1		
56	F.v. çelës fundor për furrë	copë	1		
57	F.v. rrjetë për furrë 650x530	copë	1		
58	F.v. rrjetë për furrë 530x325	copë	1		
59	F.v. mentesha për derë furre	palë	1		
60	F.v. gominë derë furre	copë	1		
61	F.v. çels per plitka sobe elektrike deri 9 pozicione	copë	1		
62	F.v. çelës per furrë sobe elektrike	copë	1		
63	F.v. alarm sinjalizues gazi plus elektrovalvolë normalisht e hapur	komplet	1		
64	F.v. sensor gazi	copë	1		
<b>Shumatore e çmimi njësi total (Shërbimet)</b>					_____
<b>Shumatore e Çmimeve për Njësi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Shumatore e Çmimeve për Njësi Total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë _____</b>					

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

## FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

### Specifikimi i Materialeve:

*Cilësia e kërkuar për materialet e vendosura për mirëmbajtjen.*

Në specifikimet teknike të sobave është e domosdoshme të respektohen instruksionet e mirëmbajtjes duke ndjekur protokollin e parashikuar në to. *Inxhinieri i zbatimit të mirëmbajtjes duhet të vendosë për pjesë ndërrimi dhe materiale të certifikuar dhe origjinale të prodhuara nga prodhuesi i pajisjeve ose ekuivalent.*

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shërbimi i mirëmbajtjes së sobave të gatimit me gaz, me gaz & energji elektrike dhe elektrike, përfshin, **inventarin e sobave sipas pasqyrës:**

Nr.	Vendndodhja	Adresa	Sobë gatimi me gaz	Sobë gatimi elektrike	Sobë gatimi me gaz dhe elektrike
	<b>NJËSIA BASHKIAKE NR.1</b>				
1	Kopshti Nr.56	Rr. "Ali Demi"	1	2	1
2	Kopshti Nr.24	Rr. "Asdreni"	1	1	1
3	Kopshti Shkoze e Re	Rr. Sotir Kuneshka	1		2
4	Çerdhja Nr.14	Rr. "Pashe Hysa"	1		2
5	Çerdhja Shkoze e Re	Rr. "Sh. Haka"	1		
6	Çerdhja Nr.50	Rr. "Pashe Hysa"	1		1
	<b>NJËSIA BASHKIAKE NR.2</b>				

1	Kopshti Nr.40	Rr. "Sali Nivica"	1		
2	Kopshti Nr.41	Rruga "Budi"	1		1
3	Kopshti Nr.18	Rr. "Mihal Grameno"	1		
4	Kopshti Sauk	Rr. Sauk (afër Xhamisë)	1		1
5	Çerdhja Nr.10	Rr. "Hoxha Tahsim"	1		2
6	Çerdhja Nr.51	Rr. "Asdreni"	1	1	1
7	Çerdhja Nr.52	Rr. "Ali Visha"	2	1	2
8	Çerdhja Nr.54	Rr. "Mihal Grameno"	1		
<b>NJËSIA BASHKIAKE NR.3</b>					
1	Kopshti Nr.1	Rr. "Qemal Stafa"	1		
2	Kopshti Nr.20	Rr. "Teli Ndini"	1	1	1
3	Kopshti Nr.29	Rr. "Qemal Stafa"	1	1	
4	Kopshti Nr.60	Rr. "Kongresi i Manastirit"	1		
5	Çerdhja Nr.15	Rr. "Qemal Stafa"	1		
6	Çerdhja Nr.26	Rr. "Qazim Vathii"	1	1	
7	Çerdhja Nr.56	Rr. "Qemal Stafa"	1		
<b>NJËSIA BASHKIAKE NR.4</b>					
1	Kopshti Nr.22	Rr. "Kongresi i Manastirit"	2		1
2	Kopshti Nr.27/A	Rr. "Njazi Meka"	1		1
3	Kopshti Nr.39	Rr. "Dibrës"	1		1
4	Kopshti Nr.51	Rr. "Dibrës"	1	1	1
5	Kopshti Nr.25/A	Rr. "Niko Avramii"	1	1	1
6	Çerdhja Nr.19	Rr. "Kinostudio"	1	1	1
7	Çerdhja Nr.34A	Rr. Sadaudin Bekteshi	2		
8	Çerdhja Nr.42	Rr. "Aleksandër Moisiu"	2	1	
9	Çerdhja Nr.48	Rr. "Bajram Curri"	1		
<b>NJËSIA BASHKIAKE NR.5</b>					
1	Kopshti Nr.11	Rr. "K. Parisit"	1		1
2	Kopshti Nr.45	Rr. "Irfan Tomini"	2		1
3	Kopshti Nr.52	Rr. "Bajram Curri"	2	1	1
4	Kopshti Nr.25/1	Rr. "Tiranë e Re"	1	1	1
5	Kopshti Nr.31	Rr. "Pjetër Bogdani"	2		1
6	Kopshti Nr.42	Rr. "Nikolla Tupe"			2
7	Çerdhja Nr.33	Komuna e Parisit	1		
8	Çerdhja Nr.16	Rr. "Nikolla Tupe"	1		2

9	Çerdhja Nr.57	Rr. "Irfan Tomini"	1		
<b>NJËSIA BASHKIAKE NR.6</b>					
1	Kopshti Nr.21	Rr. "Hamdi Cenoymeri"	1		1
2	Kopshti Nr.27/K	Rr. "Hamdi Cenoymeri"	1		1
3	Kopshti Nr.38	Rr. "Fabrika e Qelqit"			1
4	Kopshti Nr.34/K	Rr. "Hamdi Cenoymeri"			1
5	Çerdhja Nr.4	Rr. "Hamdi Cenoymeri"	1	1	
<b>NJËSIA BASHKIAKE NR.7</b>					
1	Kopshti Nr.2	Rr. "Frederik Shiroka"	1		1
2	Kopshti Nr.17	Rr. Myslym Shyri	1		
3	Kopshti Nr.26	Rr. "Frosina Plaku"	1		
4	Kopshti Nr.43	Rr. "M. Gjollësia"	1		
5	Kopshti F. Aviacionit	Fusha e Aviacionit	2		1
6	Çerdhja Nr.17	Rr. "Ylberë Bulykbashi"			2
7	Çerdhja Nr.24	Rr. "Konferen. e Pezës"	1	1	1
8	Çerdhja Nr.35	Rr. "Naim Frashëri"	1	1	
9	Çerdhja F. Aviacionit	Fusha e Aviacionit			1
10	Çerdhja Nr.47	Rr. "Myslym Shyri"	1	1	
<b>NJËSIA BASHKIAKE NR.8</b>					
1	Kopshti Nr.6	Rr. "Dibrës"	2	1	1
2	Kopshti Nr.19	Rr. "Qemal Stafa"		1	1
3	Kopshti Nr.35	Rr. "4 Dëshmorët"	1	1	
4	Çerdhja Nr.13	Rr. "Demir Gashi"	1		1
5	Çerdhja Nr.45	Rr. "Musa Agolli"	1	1	
<b>NJËSIA BASHKIAKE NR.9</b>					
1	Kopshti Nr.3	Rr. "Haxhi Hysen Dalli"	2		1
2	Kopshti Nr.36	Rr. "Fortuzit"	1		1
3	Çerdhja Nr.1	Rr. "Barrikadave"			2
4	Çerdhja Nr.23	Rr. "S. Kodra"	1		
<b>NJËSIA BASHKIAKE NR.10</b>					
1	Kopshti Nr.8	Rr. "A. Z. Çajupi"	2		1
2	Çerdhja Nr.8	Rr. "Myslym Shyri"	1		1
<b>NJËSIA BASHKIAKE NR.11</b>					
1	Kopshti Nr.14	Rr. "Lord Bayron"	1		

2	Kopshti Nr.28	Rr. "Pandi Dardha"	1	1	1
3	Kopshti Bregu Lumit	Bregu i Lumit			
4	Kopshti Kodër Kamëz	Kodër Kamëz			2
5	Çerdhja Nr.58	Bregu i Lumit	2		
6	Çerdhja Nr.59	Kodër Kamëz			1
7	Çerdhja Nr.30	Rr. "Pandi Dardha"	1		
8	Çerdhja Nr.11	Rr. "Pandi Dardha"	1	1	1
	<b>Njësia Administrative DAJT</b>				
1	Kopshtu + Cerdhe Qesarake				1

Siç vihet re sobat janë të shpërndara në 12 Njësi Administrative dhe janë gjithsej **154 copë**. Objektet parashkollore, kopshte dhe çerdhe, përdorin soba gatimi të tipeve dhe markave nga më të ndryshmet. Ato funksionojnë me energji elektrike, me gaz, me gaz dhe energji elektrike e deri tek një sobë me lëndë drusore. Sobat elektrike nuk paraqesin risk të lartë nga mosmirëmbajtja, si regull dalin nga puna për shkaqe të ndryshme si djegie rezistenca plitkash apo furre, djegie linje furnizimi me energji elektrike etj. Çdo punonjëse e di tashmë që duhet lajmëruar tekniku riparues.

Ndryshe qëndron risku i përdorimit të sobave me gaz, që janë edhe pjesa kryesore e inventarit (84 %). Por përdorimi i gazit, një material shumë i ndezshëm, sjell një rrezik. Një qasje e papërgjegjshme ndaj operacionit mund të çojë në pasoja deri në humbje jete. Në shërbimin mirëmbajtjes është parashikur:

1. Kontroll vizual për defektet;
2. Zëvendësimi (F.v.) i ndezësve të dëmtuar;
3. Riinstalimi i tubit të gazit (zakonisht është i përshtatshëm për punë për 30 vjet, por me përdorim agresiv mund të bëhet i papërdorshëm shumë më herët);
4. Lubrifikimi i valvulave;
5. Montimi i derës së furrës (mbyllja jo e plotë e saj do të çojë në kosto shtesë);
6. Diagnostifikimi i performancës së sistemit të mbrojtjes

Riparimet që do të kontrahohen për mirëmbajtjen duhet të përfshijnë, furnizimin me pjesë ndërrimi, çmontim-montimin si dhe vendosjen në funksionim normal të sobave.

Është detyrë e kontraktorit të mirëmbajtjes, zgjedhja e pajisjeve mbështetëse të tilla që mundësojnë realizimin e procesit të mirëmbajtjes dhe përzgjedhjes së "skuadrës së mirëmbajtjes" të aftë për të kuptuar dhe realizuar proceset e mirëmbajtjes të parashikuara në këtë raport.

**Një nga elementët kryesorë: Djegësi i sobës me gaz:** përdoruesit (zakonisht kuzhinierët) ndruhen të heqin kapakun, ndarësin, duke e konsideruar të rrezikshëm. Kjo është e lavdërueshme sepse shmanget hedhja e objekteve të huaja brenda. Mirëmbajtësi duhet të sigurohet që injektori të mos jetë i bllokuar (injektori-një hundë e vogël përmes së cilës gazi rrjedh nga kolektori i brendshëm përmes tubave). Kur lani tryezën e një sobë me gaz, djegësit duhet të çmontohen pjesërisht, përndryshe një funksionim me cilësi të lartë është i pamundur. Duhet të lihet djegësi të ftohet. Hiqet mbulesa, nxirret ndarësi (një detaj me dhëmbë sipër). Asnjëherë nuk lahet soba me sende gërryese (rrjetë për enët), por përdoren substancave kimike. Brenda sobës me gaz, mekanizmat e rregullimit të presionit ndihmojnë për të arritur djegie të qëndrueshme.

Në përgjithësi sobat kanë këto sisteme kryesore:

- gaz: përfshin tubacionet, çezmat, rregullatorët, ndezësit, sistemin e kontrollit të gazit, ndezësit, ndarësit;



- elektrike: sensorë të temperaturës, ndezje automatike, kohëmatës, skarë, ndriçim;
- struktura mbështetëse: përfshin trupin, sipërfaqen e punës të produktit zjarr.
- Trupi i produktit: Zakonisht e bërë nga çeliku inox ose i emaluar.
- Sipërfaqja e punës. Pjesa e sipërme e sobës, e cila ka mbrojtje kundër korrozionit dhe ndryshkut.
- Pllakat e nxehta – janë nga materiale të ndryshme, si dhe kanë dizajne dhe madhësi të ndryshme.
- Furra. Përdoret për trajtimin termik të ushqimit. Në pajisjet konvencionale funksionon në gaz, në ato të kombinuara - në energji elektrike.
- Sistemi automatik i ndezjes lejon ndezjen me siguri të një pllakë nxehtësie. Gazi ndizet nga një shkëndijë elektrike.
- Tubacioni i shpërndarjes së gazit, djegësit, valvolat mbyllëse.
- Elektronikë. përfshin kohëmatës, sensorë të temperaturës, termostate. Sodat kanë një modul softuerësh që shfaq vlerat e treguesve në një ekran të veçantë të mundësuar nga energjia elektrike.
- Sistemi i kontrollit të gazit fik automatikisht rrjedhën e gazit nëse nuk ka gaz të mjaftueshëm për të ruajtur flakën.

Operatori ekonomik me të cilin do të lidhet kontratë ka për detyrë që gjatë kontrolleve dhe shërbimeve mirëmbajtëse të kërkojë që sobat të jenë: pastruar çdo ditë dhe do marrë pjesë në pastrim të thellë çdo muaj.

Ofertuesit duhet të kenë një paketë të plotë të dokumentacionit të funksionimit dhe mirëmbajtjes konsiston në dokumentat e mëposhtëm:

- a) Informacioni teknik
- b) Procedurat rutine
- c) Procedurat speciale
- d) Defektet më të shpeshta

**Manuali i mirëmbajtjes** duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

Në “Grafikët e shërbimeve mirëmbajtëse” dhe “Urdhërat e riparimit” duhet të jepen të dhënat e mëposhtme:

- a) Të dhëna të përgjithshme
- b) Grafikun e ndërhyrjeve të mundshme
- c) Riparimet e nevojshme
- d) Garancinë
- e) Të dhëna mbi instalimin, funksionimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen
- f) Inventarizimin e pjesëve të ndërrimit
- g) Veprimet mbrojtëse të mirëmbajtjes (kujdesin ndaj goditjeve elektrike dhe rrjedhjes së gazit)
- h) Përshkrimin e veprimeve ndërhyrëse
- i) Historikun e ndërhyrjeve mirëmbajtëse

**TË GJITHA MATERIALET DHE PJESËT E NDËRRIMIT QË DO TË PËRDOREN PËR RIPARIME ME ZËVËNDËSIM PJESËSH DO TË JENË MATERIALE TË CERTIFIKUARA DHE ORIGJINALE TË PRODHUARA NGA PRODHUESI I PAJISJEVE OSE EKVIVALENT QË PËRMBUSHIN STANDADET CE.**

---

## Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

#### **Shërbimet që kërkohen:**

Bazuar në marrëveshjen Kuadër që do të lidhet me OE të sukseshëm, Autoriteti kontraktor do të lidhë (mini)kontrata sipas nevojave për të arritur të funksionojnë normalisht të gjitha kondicionerët nëpërmjet kryerjes së shërbimeve teknike të programuara dhe riparimeve të nevojshme. Do të kërkohet realizimi i të gjithë shërbimve të parashikuara si dhe riparimet e nevojshme në llojshmëri. **Sasia është e pritshme.**

#### **Afatet e ekzekutimit:**

Kontratat e lidhura bazuar në Marrëveshjen Kuadër do të zbatohen si vijon:

1. Për shërbimet teknike mirëmbajtëse, me njësi matëse "Orë pune", hartohet Grafik shërbimesh të programuara nga grupi i punës për ndjekjen e zbatimit të kontratave. OE merr një kopje dhe e zbaton në sasi, cilësi dhe afatin e urdhëruar.
2. Për riparime me njësi matëse "F.v. (furnizim vendosje)", me lindjen e nevojave, Grupi i punës lëshon "Urdhër riparimi" ku jepet sasia, çmimi njësi sipas kontratës lidhur në bazë të MK dhe afati i ekzekutimit (realizimit).

#### **1. Grafiku i ekzekutimit të shërbimeve mirëmbajtëse**

**Sipas shtojcës "Formulari dhe grafiku i ekzekutimit të shërbimeve" bashkëlidhur DST**

---

## Shtojca 7

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

**Objekti i Shërbimit mirëmbajtës:** Sigurimi i gatishmërisë teknike dhe funksionimit normal të sobave të gatimit duke krijuar kushte optimale pune. Hartimi i manualit të përdorimit dhe mirëmbajtjes.

**Qëllimi i shërbimit mirëmbajtës:** Mundësimi i një kontrate për **riparim-mirëmbajtje** të sobave të gatimit në objekte parashkollore në juridiksionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

Të gjitha materialet e tjera që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje duhet të jenë të certifikuara konform standartit (CE). Në përgjithësi materialet e kërkuara janë të specifikuara edhe në listën e çmimeve apo formularin e shërbimeve, dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga ofertuesi.

Detyrat:

**Kontrata zbatohet** me grafik riparim-shërbimesh të programuara mujore dhe urdhëra riparimi të lëshuara nga AK sipas nevojave. Operatori ekonomik gjatë zbatimit të kontratës do të mbajë kontakt të përditshëm me përfaqësues të AK të ngarkuar për ndjekjen e planit (procedurës) të zbatimit të kontratës, plan të cilin OE dhe AK e nënshkruajnë brenda 7 (shtatë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Do të realizohet zhvendosja në ambient të jashtëm e të gjithë bombilave të gazit. Autoriteti Kontraktor do të marrë masa për realizim ambienti të jashtë aty ku nuk ekziston. Detyrat e tjera si shtrirja e tubacioneve, furnizimi dhe instalimi i kafazëve metalik për bombolat do të realizohen nga operatori ekonomik i suksesshëm.

Shpërndarja:

Objektet parashkollore në juridiksion të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë

Sasitë e pritshme jepen në shtojcën "Formulari dhe grafiku i ekzekutimit të shërbimeve".

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

##### **2.1.1. Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:**

a. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale e cila të përmbajë kategoritë, sipas modelit të lëshuar nga MPPT:

NS – 12 (A) Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

##### **2.1.2 Përsa i përket aftësisë teknike dhe profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të vendosura nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

a. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësive, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. (dokumentacioni të paraqitet në gjuhën shqipe ose i perkthyer dhe e noterizuar).

b. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me ISO 14001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. (dokumentacioni të paraqitet në gjuhën shqipe ose i perkthyer dhe e noterizuar).

Enti certifikues për lëshimin e certifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i njohur nga Drejtoria e Akreditimit Shqiptar. Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike certifikatat janë të detyrueshme për të gjithë operatorët sipas llojit dhe sasisë së shërbimeve

---

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.*

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**2.2.2** Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë **3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, jo më pak se 20 % të vlerës së përlllogaritur të marrëveshjes kuadër (Fondi Limit ose vlera e kontratave të pritshme).

Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**2.3.2** Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre specialistët e domosdoshëm për të realizuar objektin e këtij prokurimi si mëposhtë minimumi:

6 (gjashtë) punonjës të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën minimumi Tetor - Dhjetor 2023:

1 (nje) Inxhinier Mekanik

1 (nje) mekanik, i kualifikuar, i pajisur me diplome të shkolles së mesem profesionale mekanike

2 (dy) punonjës elektrikistë, të jete të pajisur edhe me dëshmi kualifikimi nga organizëm i akredituar në Shqipëri.

1 (një) punonjës të trajnuar nga organ i licensuar për ndërhyrjen ndaj emergjencave dhe ndihmën e parë.

Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë “Dokumentin e Vleresimit të Riskut (DVR)”, në pajtim me Ligjin nr 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shendetin në

---

Punë”, i ndryshuar, sipas fushes së objektit të veprimtarisë. (në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, mjafton disponueshmëria e 1 DVR për të gjithë BOE)

*(Kriteret 2.3.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.)*

Shënim: Një punonjës mund të ketë më shumë sesa një kualifikim/ trajnim nga ato të kërkuara më sipër.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të lëshuar nga Administratori i shoqërisë, person përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj kontrate, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Diplomë
- Kontrata pune të vlefshme

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën:

1 (një) automjet për transportin e mallrave, të cilat duhet t'i ketë në pronësi/me qira/mbështetje nga një operator ekonomik;

1 (një) motocikletë për riparimet emergjente të cilat duhet t'i ketë në pronësi/me qira/mbështetje nga një operator ekonomik;

Për vërtetimin e kësaj kërkesë duhet të paraqesë, Leje Qarkullimit, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, Akt-kontrollin teknik (Kolaudimin) të vlefshme, ose në rast se nuk i ka në pronësi të paraqesë kontratën e qirasë ose një deklaratë mbështetje nga një operator ekonomik ku të deklarohet se mbështetja e tij për këtë kapacitet teknik ofrohet për një afat sa kohëzgjatja e kontratës së parashikuar si dhe dokumentacionin shoqëruar për qarkullimin e mjeteve të kërkuara (Leje Qarkullimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, akt-kontrollin teknik (Kolaudimin) të vlefshme).

*(Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.)*

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë se të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje janë të çertifikuara (CE).

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë se merr përsipër kryerjen e riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë gjatë gjithë ditëve kalendarike të përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe pjesët e ndërrimit do të furnizohen nga prodhuesi ose distributor i autorizuar.

**SHËNIM:** Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (të ndryshuar), ku konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:.....Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.....

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6 të nenit 26, të Rr.P.P., brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1, të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

## Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

#### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin



Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

